



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:291001

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05474500

**NË EMËR TË POPULLIT**

**P.nr../..**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Mus Povataj, me pjesëmarrjen të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit R.. M.. për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të KPRK-së, i akuzuar nga Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme sipas aktakuzës PP/II nr.2442/23 të datës 21.12.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 21.02.2024 në prezencë të Prokurores se Shtetit Ardiana Veseli të pandehurit R.. M.. të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht, ndërsa me datë 19.03.2023 përpilon këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri,**

**R.. M..** i lindur më datë ..... në Pejë Rr. A.. J.. nr. ..., nga babai H., dhe nëna S., e gjinisë K., i pa martuar, me profesion IT dhe punon në “B.. G..” P..ë, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..... posedon numër te telefoni ....., shqiptar, Shtetas i/e Republikës së Kosovës, mbrohet ne liri.

**ËSHTË FAJTOR**

Për shkak se:

Me dt.01.11.2023, rreth orës 13:40 në Rr.”A.. J.. në .. pa autorizim posedon narkotik substanca psikotrope ose analoge të shpallura të rrezikshme në kundërshtim me nenin 9 dhe nenin 14 të Ligjit për barnat narkotike substanca psikotrope dhe prekusore nr.02/L-128 dhe atë të llojit marihuanë, në atë mënyrë që te pandehurit gjatë kontrol nga zyrtaret policor i është gjetur dhe sekuestruar një qese me narkotikë dhe një cigare xhoit qe dyshohet te jetë me substancë te dyshuar narkotike te llojit marihuan, ku nga ekzaminimi laboratorik në DHTN në Pejë është konstatuar se D #1 dhe D#2, kishte në posedim 1.3 gram, substancë narkotike të llojit Marihuanë.

- me çka ka kryer, veprën penale, posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 parag.1, të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve: 7, 17, 21, 38, 43,47, 49, 69,70 dhe 269 par.1 të KPRK-së, si dhe nenet 242 dhe 364, të KPPRK-së, të pandehurit R.. M.. i shqipton:

**DËNIM ME BURG** në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit komfor neni 44 të KPRK-së, i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumën prej 200 (dyqind) euro dhe **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej 100,00 € (njëqind euro).

Konform neni 76 të KPRK-së të pandehurit i shqiptohet **DËNIM UNIK ME GJOBË** në shumë prej **300,00 € (treqind euro)**, të cilin dënim i pandehuri do ta paguaj brenda 1 (një) muaji, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë të cekur si më lartë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti shndërrohet në dënim me burg, ku një ditë burg do ti llogaritet 20 euro.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € (njëzetë) euro dhe në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 (njëzetë) euro në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

I konfiskohet të akuzuarit substanca narkotike e llojit marihuanë, në peshë prej 1.3 gram.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme me datën 21.12.2023 ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2442/23 ndaj të akuzuarit R.. M.. për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të KPRK-së.

Ne shqyrtimin fillestar të datës 21.02.2024 gjykata në pajtim me nenin 241 par. 1 të KPPRK-se e ka udhëzuar të pandehurin për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaroi për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtojë aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

Pasi i pandehuri ka hequr dorë nga e drejta e leximit të aktakuzës gjykata është bindur se i pandehuri i ka kuptuar aktakuzat dhe nuk kanë nevojë për sqarime shtesë. Me pas gjykata e ka njoftuar të pandehurin për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë.

I pandehuri është deklaruar fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet duke shtuar, jam penduar dhe shton se është e vërtetë që e kam kryer këtë vepër dhe premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprimet të këtilla.

Në vlerësimin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit të Shtetit e cila ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, i njëjti pranim është bere ne mënyrë vullnetare nga i pandehuri dhe po ashtu gjen mbështetje në shkresat e lëndës.

Gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se në seancën e shqyrtimit kryesor nuk ekzistojnë rrethana për hedhjen e aktakuzës nga neni 244 i KPPRK-së, si dhe janë vërtetuar faktet nga neni 242 par. 6 të KPPRK-se, ndërsa aktakuza mbështet në këto prova siç janë: Raporti fillestar Incidentit me nr të rastit 2023-DA-1834 e dt.01.11.2023 nga polici hetues F.. D.. #11412, Raporti i Policit F.. D.. #11412 e dt.01.11.2023, Raporti i Oficerit K.. S.. KPS 11165 e dt.01.11.2023, Raporti Infomrues nga V.. G.. # 9764 e dt.01.11.2023, deklarata e të dyshuarit R.. M.. e dhënë në Stacionin Policor në Pejë me dt.01.11.2023, Vërtetimi mbi Sekuestrimin e Përkohshëm të Sendeve me nr 2023-DA-1834 e dt.01.11.2023, Raporti i Analizës së Narkotikeve të NAR-testit të dt. 03.11.2023 , Fotografitë nga substanca narkotike konfiskuar, si dhe të bëhet shikimi në shkresat tjera të lëndës, andaj ka marr aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri duke vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Andaj me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i cili mbështet në provat në baze të së cilave bazohet aktakuza është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale nga neni 296 par.1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 par.1, 2 dhe 3 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurën, gjykata mori pranimin e fajësisë, keqë ardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata ka gjetur shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale dhe faktin që me parë ka qenë i dënuar për vepër të njëjte penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vlerësuar se me dënimin e shqiptuar si në dispozitat të këtij aktgjykimi mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPPRK-së, e obligoi të akuzuarin që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 20,00 € për paushallit gjyqësor dhe 20,00 € për taksen për programin për kompensimin e viktimave të krimit.

Konform nenit 269 par.3 të KPRK-së gjykata të akuzuarit i ka konfiskuar substancën narkotike e llojit marihuanë, në peshë prej 1.3.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa komfor nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloj këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE PEJË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL  
2023:291001, 19.03.2024**

**Bashkëpunëtorja profesionale**

\_\_\_\_\_  
Edona Berisha Kastrati

**G j y q t a r i**

\_\_\_\_\_  
Musë POVATAJ

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate